



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUSHAJ
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1
Tirane
TEL: 0692097547

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 3269

Nr. koleksioni: 1562

Tirane më 05/10/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti notarial përbëhet nga 4 fletë



A2021053540177037912



A2021053540177037912

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AVA STUDIO” SH.P.K**

Sot më datë 05/10/2021 (dymijë e njëzetë e një), përpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Rruga “Vaso Pasha”, pall. 13/1, u paraqit personalisht:

THEMELUESE: **Valbona Xoxa**, atësia Xhemil, amësia Ganimet, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Kodra e Diellit 03910066; Nd. 76, H. 1, Farkë, Selitë, 1044, Tiranë, lindur më datë 08.10.1958, gjendja civile “e ve”, madhore dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova me letërnjoftim me nr. 033094353 dhe nr. personal F86008097P.

E cila ka vendosur të nënshkruajë këtë Akt Themelimi dhe Statut të shoqërisë “**AVA Studio**” Sh.p.k, mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Kodin Doganor, Fiskal dhe Tatimor, si më poshtë:

**KAPITULLI I
THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria “AVA Studio” Sh.p.k. (në vijim “**Shoqëria**”) themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm dhe funksionon sipas këtij Statuti dhe Akti Themelimi.
- 1.2. Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1. Emërtimi i Shoqërisë është “AVA Studio” Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i Shoqërisë

- 3.1. Shoqëria ka për objekt ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në fushën e botimit, artit dhe kulturës, në fushën sociale dhe në atë edukuese dhe në fushën e turizmit, si më poshtë vijojnë, por pa u kufizuar vetëm në to:
 - 3.1.1. Në fushën e botimit:
 - a) Shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e librave të të gjitha llojeve, broshurave, katalogeve, fletëpalosjeve, materialeve prezantuese, revistave, gazetave, publikimeve periodike apo të përditshme, si dhe të çdolloj produkti tjetër që ka

Xoxa



A2021053540177037912

- të bëjë me shtypin e shkruar, elektronik, apo çdolloj forme tjetër shkrimi;
- b) Tregtimin me shumicë ose me pakicë të artikujve të mësipërm, fizikisht por edhe përmes platformave elektronike, importin dhe eksportin e tyre, si dhe zhvillimin e aktiviteteve përfaqësuese apo promovuese, me apo pa depozitë, të artikujve të lartpërmendur.
 - c) Përkthimin në gjuhën shqipe apo të huaj të botimeve të ndryshme si edhe tregtimin me pakicë apo me shumicë të tyre.

3.1.2. Në fushën e artit dhe kulturës:

- a) Organizimin, menaxhimin dhe ofrimin e kurseve formuese teorike dhe praktike në fushën e artit/kulturës, të tilla si kurse vizatimi, pikturë, veglash muzikore, aktrimi etj., për fëmijë, adoleshentë dhe të rritur të cilët dëshirojnë të trajnohen në sektorët e lartpërmendur dhe të integrohen në tregun e punës;
- b) Promovimin, ideimin, realizimin, përgatitjen, menaxhimin dhe/ose ndërmjetësimin e *workshop*-eve, eventeve të ndryshme kulturore, turistike dhe shfaqjeve artistike në përgjithësi, konferencave, mbledhjeve, prezantimeve, seminareve, performancave, shfaqjeve, koncerteve, festivaleve, sfilatave, tregjeve, panairove, ekspozimeve, ekspozitave, instalacioneve, ceremonive, konkurseve të ndryshme, rezidencave artistike etj.;
- c) Konsulencë, këshillime, trajnime profesionale lidhur me çdolloj veprimtarie që ka të bëjë me artin dhe kulturën;
- d) Kryerjen e veprimtarive kërkimore, dokumentuese, informuese apo edhe reklamuese mbi artin dhe kulturën nëpërmjet shpërndarjes dhe shitjes së broshurave, fletëpalosjeve, manualeve si dhe çdolloj materiali tjetër që lidhet me artin dhe kulturën;
- e) Organizimin e projekteve të ndryshme edukuese përmes artit dhe kulturës në Shqipëri dhe në botë, për fëmijët, adoleshentët, të rriturit, apo edhe për grupe të ndryshme shoqërore, të tilla si grupet e marginalizuara të shoqërisë;
- f) Prodhimin, menaxhimin, shpërndarjen etj. të filmave, dokumentarëve, emisioneve apo videove të llojeve të ndryshme;
- g) Nxitjen e bashkëpunimit artistik dhe kulturor mes shoqërisë shqiptare dhe atyre ballkanase apo edhe shoqërive evropiane apo ndërkombëtare, pa dallim shtetësie.

3.1.3. Në fushën social-shëndetësore dhe social-edukuese:

- a) Ushtrimin e veprimtarive që lidhen me shërbimet social-shëndetësore dhe social-edukative si më poshtë vijojnë, por pa u kufizuar vetëm në to:
 - veprimtari parandaluese, edukuese, mbështetëse, rehabilituese dhe integruese në ambientin familjar, shkollor dhe shoqëror, në favor të personave që gjenden në situata të vështira;
 - veprimtari kulturore, kërkimore, dokumentuese, informuese dhe ndërgjegjësuese lidhur me problemet që kanë të bëjnë me vështirësitë shoqërore dhe aftësitë e kufizuara;
 - veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grupeve në nevojë kryesisht të drejtave të grave dhe të rinjve me mundësi të pakta integrimi social dhe ekonomik;
 - veprimtari që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të zonave informale në Shqipëri, si dhe integrimin e tyre me pjesën tjetër të qyteteve;

Handwritten signature



A2021053540177037912

- veprimtari mbështetëse arsimore (edukuese) për të rinjtë me mundësi të ulta të integritit social dhe ekonomik;
 - veprimtari trajnuese që ndikojnë në aftësimin e grupeve në nevojë, të tilla si gratë, të rinjtë, të moshuarit etj.,
 - veprimtari shkëmbyese social-edukuese dhe social-shëndetësore me shoqëri të tjera, shoqata, qendra, institute apo fondacione shqiptare apo të huaja që operojnë në fushën sociale dhe shëndetësore;
 - veprimtari informuese dhe orientuese.
- b) Promovimin e nismave që synojnë tejkalimin e situatave të marginalizuara me qëllim favorizimin e pjesëmarrjes në jetën familjare, shkollore, shoqërore dhe produktive;
- c) Sensibilizimin e komunitetit ndaj problemeve social-shëndetësore dhe social-edukuese përmes promovimit dhe organizimit të konferencave, tryezave të rrumbullakëta, seminareve, si dhe çdolloj veprimtarie tjetër që synon sensibilizimin ndaj problemeve të lartpërmendura.

3.1.4. Në fushën e promovimit:

- a) Kryerjen e veprimtarive turistike me qëllim promovimin e vendit tonë;
- b) Menaxhimin dhe kryerjen e veprimtarive informuese dhe turistike që kanë të bëjnë me promovimin, rritjen dhe rikualifikimin e zhvillimit turistik vendas apo të huaj, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me persona juridikë apo individë, institucione të ndryshme shtetërore apo private etj.;
- c) Shpërndarjen dhe shitjen e manualeve, udhëzuesve, hartave, broshurave ilustruese dhe informuese, si dhe të çdo publikimi tjetër që lidhet me fushën e turizmit, shfaqje artistike, kulturore dhe sportive dhe evente të ndryshme;
- d) Menaxhimin dhe rezervimin e shërbimeve në kontekstin e ekspozitave, eventeve të ndryshme turistike, kulturore, artistike, sportive, panairove, kongreseve etj., si brenda territorit ashtu edhe jashtë tij;
- e) Konsulencë dhe asistencë profesionale të përgjithshme dhe të posaçme lidhur me sektorin e artit, kulturës dhe turizmit për kompanitë si dhe për çdo subjekt tjetër privat apo publik;
- f) Promovimin dhe zhvillimin e artizanatit dhe produkteve tradicionale shqiptare, evidentimin dhe ruajtjen e vlerave autentike shqiptare përmes eventeve të ndryshme si për shembull panairove, por edhe nëpërmjet shitjes së tyre online përmes një platforme të dedikuar ose në dyqan, brenda dhe jashtë territorit shqiptar;
- g) Ideimin, projektimin, organizimin dhe realizimin e eventeve të ndryshme dhe të çdo veprimtarie lidhur me promovimin dhe zhvillimin e artit, kulturës dhe turizmit.

3.1.5. Të tjera:

- a) Menaxhimin e strukturave të rezidencave artistike, vendeve të dedikuara për kampingje apo shkolla verore jo-profesionale, dhe ushtrimin e çdo veprimtarie akomoduese (pritëse)-turistike në përgjithësi, si në mjediset e vetë Shoqërisë ashtu edhe në ato të palëve të treta;
- b) Gëzimin, menaxhimin, dhënien me qira, nënqira, hua dhe administrimin e pasurive të paluajtshme të çdo natyre dhe lloji;
- c) Me qëllim përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund të kryejë realizimin e

Nov 9



A2021053540177037912

punimeve të ndërtimit të çdolloji dhe natyre duke përfshirë ndërtimin, ristrukturimin e pasurive të paluajtshme dhe përmirësimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi, si dhe blerjen, shitjen, shkëmbimin e pasurive të paluajtshme të çdo lloji dhe natyre

- 3.2 Shoqëria ka gjithashtu për objekt krijimin e produkteve të veshjes apo të kozmetikës, prodhimin apo tregtimin e tyre, importimin apo eksportimin e tyre, përmes dyqaneve fizike apo platformave dixhitale, si brenda dhe jashtë vendit.
- 3.3 Shoqëria ka gjithashtu për objekt menaxhimin, si vetë ashtu edhe me pjesëmarrje të jashtme, e çdo lloj licence, konçesioni dhe të ngjashme, shitblerjen e shoqërive tregtare, pagesën dhe/ose arkëtimin e “royalties”, menaxhimin e joint ventures, franchising, lidhjen e tipologjive të marrëveshjeve të ngjashme dhe/ose bashkëpunimeve me të tretë, si në Shqipëri, ashtu dhe jashtë saj (si për llogari të saj, ashtu edhe për llogari të të tretëve), sikurse parashikuar nga ligji.
- 3.4 Pjesëmarrjen, financimin, sponsorizimin dhe/ose realizimin e projekteve që lidhen me ofrimin e shërbimeve në të gjitha fushat e përmendura më lart në të cilat Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj.
- 3.5 Shoqëria do të mund të blejë pjesëmarrje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, ente, konsortiume, të themeluara apo në themelim, shqiptare ose të huaja, të cilat kanë objekt të ngjashëm apo sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritjes së qëllimeve të Shoqërisë.
- 3.6 Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër që, edhe pse nuk ka lidhje me sa është parashikuar më sipër, nuk përbën një veprimtari të ndaluar me ligj dhe që është në funksion të përmbushjes së objektit të Shoqërisë.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën rruga “Brigada VIII”, Ndërtesa nr. 19, Hyrja 5, Kati 10, Apartamenti 31, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Ortakut të vetëm.
- 4.3. Ortaku i vetëm mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



A2021053540177037912

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë.
- 6.2. Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me një vlerë prej 100.000 (njëqind mijë) Lekësh.

Neni 7 – Kontributet dhe kuotat

- 7.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lekë, përbëhet nga 1 (një) kuotë, dhe zotërohet nga Ortaku i vetëm si më poshtë:

Valbona Xoxa, e bija e Xhemilit, shtetase shqiptare lindur më 08.10.1958 në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal F86008097P, e cila është pronare e të gjithë kapitalit të Shoqërisë “AVA Studio” sh.p.k.

- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
Ortaku i vetëm, Valbona Xoxa, zotëron 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të vetëm.
- 8.2. Në rast rritjeje të kapitalit, kuota e ortakut do të rritet sipas shumave të përcaktuara në vendimin për rritjen e kapitalit.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Ortakut të Vetëm. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortaku sipas shumave të përcaktuara në vendimin për zvogëlimin e kapitalit.

Neni 10 – Transferimi i kuotave të kapitalit

- 10.1. Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme sipas nenit 73 të Ligjit 9901, i datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.



A2021053540177037912

KAPITULLI III ORTAKU I VETËM, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 – Ortaku i vetëm

- 11.1. Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i vetëm.
- 11.2. Ortaku ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 11.3. Ortaku i vetëm mund të thirret në çdo moment nga Administratori. Në çdo rast, Ortaku i vetëm duhet të marrë vendim së paku një herë në vit për të shqyrtuar dhe miratuar bilancin e periudhës ushtrimore financiare të mëparshme.
- 11.4. Ortaku i vetëm, nëse thirret nga Administratori, duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje e cila duhet t'i dërgohet atij – në adresën që rezulton në dokumentet e Shoqërisë – të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, vendin, orën dhe datën e mbledhjes.
- 11.5. Ortaku i vetëm mund të marrë vendime edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo në një vend të huaj.

Neni 12 – Administrimi

- 12.1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, emëruar prej Ortakut të vetëm, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e tij, apo për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh. Ai mund të rizgjidhet për të njëjtin afat. Administrator mund të jetë edhe vetë Ortaku i vetëm.
- 12.2. Administrator caktohet **Valbona Xoxa**, atësia Xhemil, shtetase shqiptare, e dtl 08.10.1958, lindur dhe banuese në Tiranë, në adresën Kodra e Diellit 03910066; Nd. 76, H. 1, Farkë, Selitë, 1044, Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal F86008097P, me cel: +355 69 220 1874, me e-mail: amarku@thepartners.al, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, emëruar prej Ortakut të Vetëm, e cila qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e saj, apo për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
- 12.3. Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i takon Administratorit. Administratori do të kryejë të gjitha aktet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përjashtuar kompetencat të cilat i përkasin organeve të tjerë të Shoqërisë sipas ligjit të aplikueshëm apo sipas këtij statuti.
- 12.4. Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

Xoxa



A2021053540177037912

Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 13.1. Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Ortaku i vetëm, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një ekspert kontabël të autorizuar.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 14 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 14.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

Neni 15 – Fitimet

- 15.1. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur të gjitha shumatat që Ortaku i vetëm vendos t'i vërë mënjanë, i shpërndahen Ortakut, ose me vendim të tij riinvestohen apo kapitalizohen brenda Shoqërisë.
- 15.2. Ortaku i vetëm mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve - plotësisht ose pjesërisht - për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 16 – Shpërndarja

- 16.1. Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me anë të një vendimi të Ortakut të vetëm.
- 16.2. Shoqëria nuk priset në rast të falimentimit të ortakut.

Neni 17 – Likuidimi

- 17.1. Në rast shpërndarje, shoqëria duhet të likuidohet.
- 17.2. Për të administruar këtë procedurë, Ortaku i vetëm emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 17.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Ortaku i vetëm do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 17.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakut.



A2021053540177037912

Neni 18 – Gjuha

18.1. Ky statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 19 – Dispozita përfundimtare

- 19.1. Lidhur me çka nuk është parashikuar shprehimisht prej këtij statuti dhe akti themelimi do të zbatohet ligji shqiptar mbi shoqëritë tregtare.
- 19.2. Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të jetë kompetente Gjykata e Tiranës.

* * *

Unë, Noterja verifikova identitetin e subjektit nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje me ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e saj. Ky Statut dhe Akt Themelimi nënshkruhet lirisht prej palës në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimin e tij sipas ligjit.

THEMELUESE
VALBONA XOXA

Valbona Xoxa
Xoxa

NOTERE
MIMOZA SADUSHAJ

